

EUROGREN SH.P.K.
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

AKTIVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	38,874	16,699
Llogari të arkëtueshme	5	3,783,201	3,973,201
Inventari	6	87,100	87,100
Aktive të tjera afatshkurtra	7	6,759,259	6,688,405
Total Aktiveve Afatshkurtra		10,668,434	10,765,405
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	18,456,721	18,456,721
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,568,700	1,568,700
Kapitali aksionar i pa paguar		1,494,000	1,494,000
Total aktive afatgjata		21,519,421	21,519,421
Total Aktive		32,187,855	32,284,827
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tegetare	10	328	328
Llogari te pagueshme te tjera	11	351,751	351,751
Total Detyrime afatshkurtra		352,079	352,079
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	12	28,543,739	26,550,230
Provizione Afatgjata		152,398	152,398
Total Detyrime afatgjata		28,696,137	26,702,628
Totali i detyrimeve		29,048,216	27,054,707
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	13	51,776,625	51,776,625
Fitime te mbartura		(46,546,506)	(44,959,835)
Fitimi i ushtrimit		(2,090,480)	(1,586,671)
Total kapitali aksionar		3,139,639	5,230,119
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		32,187,855	32,284,827

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN SH.P.K.

Pasqyra Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Te ardhura	14	1,680,000	1,860,000
Shpenzime personeli	15	(1,008,288)	(1,036,296)
Shpenzime te tjera	16	(642,901)	(342,295)
Fitimi operativ		28,811	481,409
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	17	(2,113,510)	(2,029,096)
Total shpenzime financiare		(2,113,510)	(2,029,096)
Fitimi para tatimit		(2,084,699)	(1,547,687)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(5,781)	(38,984)
Fitimi i vitit		(2,090,480)	(1,586,671)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


EUROGREN SHPK
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	51,776,625	(44,959,835)	6,816,790
Fitimi i vitit		(1,586,671)	(1,586,671)
31 Dhjetor 2013	51,776,625	(46,546,506)	5,230,119
Transferim në rezerva të tjera			-
Fitimi i vitit		(2,090,480)	(2,090,480)
31 Dhjetor 2014	51,776,625	(48,636,986)	3,139,639

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë Eurogren sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 20 Mars 2015 nga:


Edmond Mersini
Administrator


Mazars Shpk

EUROGREN SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

**Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014**

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(2,084,699)	(1,547,687)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Shpenzime për interesa	2,123,241	1,937,484
Rezultati nga diferencat e kembimit		
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	181,845	(321,356)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	-	(33,954)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	220,387	34,487
Interesa te paguara	(2,123,241)	(1,937,484)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit	(68,480)	(54,496)
	(2,191,721)	(1,991,980)
Aktivitetet investuese		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	-	-
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata	1,993,509	1,956,050
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	1,993,509	1,956,050
	-	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	22,175	-1,444
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	16,699	18,143
Mjetet monetare ne fund te periudhës	38,874	16,699

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

"Eurogren" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim gjykatë të rrethit Tirane Nr.11574 datë 14.07.1995. ne perputhje me Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare", si edhe nga statuti i saj.

Ortaket e shoqerise jane:

Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes qe zoteron 29% te kapitalit;

Z.Edmond Mersini qe zoteron 23.68% te kapitalit;

Z.Hasan Hazifi qe zoteron 23.66% te kapitalit;

Znj. Mirela Mula qe zoteron 23.66% te kapitalit.

Aktiviteti kryesor i kesëj shoqërie është prodhim, perpunim, tregtim, eksportim dhe importim te detaleve gjysemfabrikate prej druri, te lendeve drusore te gjithëfarlojshme te sharruar, artikujve te tornuar e te profiluar, makinerive te perpunimit te drurit, organizimit dhe kryerjes se sherbimit te transportit per mallrat e ndryshem dhe pasagjere, te ushqimit social etj. Aktiviteti i shoqerise eshte parashikuar te jete pa nderprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Konferenca e Pezes", Nd.73, H.1, Njesia nr.6, Tirane. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me Kod Fiskal 3705911 dhe NIPT J 661814077 J.

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 2 punonjës.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

ulerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.3 Aktive afatgjata materiale***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%
Ndertesa	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare ne banke	25,535	3,361
Llogari rrjedhese	25,535	3,361
Mjete monetare ne arke	13,339	13,338
	<u>38,874</u>	<u>16,699</u>

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente	19,090,875	19,280,875
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(15,307,674)	(15,307,674)
	<u>3,783,201</u>	<u>3,973,201</u>

6. INVENTARI

Gjendjet e Inventarit me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 jane si me poshte :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Produkte dhe mallra	5,725,175	5,725,175
Te tjera gjendje inventari	87,100	87,100
Provizione per zhvleresime	(5,725,175)	(5,725,175)
Totali	<u>87,100</u>	<u>87,100</u>

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shteti – TVSH për tu mare	28,490	20,335
Detyrime doganore	-	-
Tatim Fitimi	1,906,977	1,844,278
Te tjera	4,823,792	4,823,792
Totali	<u>6,759,259</u>	<u>6,688,405</u>

EUROGREN SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

8. AKTIVE AFATGJATA

	Toka	Ndertesa	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Zhvierësimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721

(Vlerat janë në Lek)

9. AKTIVE JOMATERIALE

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	4,980,000	4,980,000
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	4,980,000	4,980,000
Amortizimi		
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	3,411,300	3,411,300
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	3,411,300	3,411,300
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2013	<u>1,568,700</u>	<u>1,568,700</u>
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2014	<u>1,568,700</u>	<u>1,568,700</u>

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të mamberritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Furnitore vendas	328	328
	<u>328</u>	<u>328</u>

11. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga për t'u paguar	61,336	58,936
Sigurime shoqërore & shëndetësore	20,078	20,078
Tatimin mbi të ardhurat personale	2,600	5,000
Debitore & kreditore të tjera	267,737	267,737
	<u>351,751</u>	<u>351,751</u>

12. HUATE AFATGJATA

Gjendja e huase dhene nga ortakët më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Hua nga ortakët	28,543,739	26,550,230
	<u>28,543,739</u>	<u>26,550,230</u>

13. KAPITALIAKSIONAR**Kapitali themeltar**

Gjate vitit 2014 nuk ka pasur ndrushime ne kapitalin e shoqerise.

14. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga qeraja	1,680,000	1,860,000
	<u>1,680,000</u>	<u>1,860,000</u>

Rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar ne FDP e TVSH eshte si me poshte:

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne e Tatim Fitimit	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	1,680,000
Zbriten Autofaturimet 2014	
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	<u>1,680,000</u>
Fitim nga kembimet valutore	9,732
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	<u>1,689,732</u>

15. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	864,000	888,000
Shpenzime per sigurime shoq e shend	144,288	148,296
	<u>1,008,288</u>	<u>1,036,296</u>

16. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe ato të mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë të analizuar si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Taksa të ndryshme lokale	595,420	295,180
Konsulenca ekonomike dhe juridike	40,000	40,000
Energji elektrike	781	548
Shpenzime administrative	1,200	1,100
Komisione bankare	5,500	5,467
	<u>642,901</u>	<u>342,295</u>

17. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime për interesa	(2,123,241)	(1,937,523)
Te ardhura nga interesat	-	39
Humbje nga kembimet valutote	-	(91,612)
Te ardhura nga kembimet valutore	9,731	-
	<u>(2,113,510)</u>	<u>(2,029,096)</u>

18. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
Fitimi para tatimit	(2,084,699)	(1,547,687)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,123,241	1,020,063
Shpenzime udhëtimi	-	22,402
Penalitet, gjoha e demshperblime	-	25,824
Shpenzime interesash të panjohura	2,123,241	145,948
Shpenzime zhvleresimi (provizione)		825,889
Shpenzime të tjera		<u>825,889</u>
Fitimi Tatimor	38,542	(527,624)
Humbje fiskale e mbartur		-
	38,542	-527,624
Tatim fitimi 15%	5,781	(52,762)
	<u>(2,090,480)</u>	<u>(1,494,925)</u>

19. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

20. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.